

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Ky dokument përbën një marrëveshje të lidhur midis Pirro Sh.p.k., e regjistruar pranë QKR me (NIPT) K31419099E, me seli në adresën: Rruga Gjin Bue Shpata, Pallati 5/1, Tiranë, dhe klientëve përkatës, e cila parashikon Kushtet e Përgjithshme të blerjes nga këta të fundit në rrugë elektronike të produkteve të Pirro Sh.p.k. nëpërmjet faqes së internetit www.pirro.al (në vijim referuar si **“Kushtet e Përgjithshme”**)

Duke kryer porosi dhe duke bërë blerje në rrugë elektronike nëpërmjet faqes së internetit www.pirro.al, Ju pranoni pa asnjë rezervë të gjitha “Kushtet e Përgjithshme”. Këto Kushte të Përgjithshme zbatohen për të gjitha shitjet nëpërmjet faqes së internetit të Pirro Sh.p.k., si për rastet nëse produktet dorëzohen në adresën e përcaktuar nga Klienti, edhe në rastet nëse ato tërhiqen në dyqane.

Në rast ndryshimi të Kushteve të Përgjithshme, ndryshimet përkatëse do të publikohen në këtë faqe interneti. Në rast ndryshimesh, ato nuk do të kenë fuqi prapavepruese.

Pirro Sh.p.k. nuk mban përgjegjësi nëse gjatë navigimit në këtë faqe interneti mund të shkarkohen materiale të padëshirueshme apo të pakonfirmuara nga Klienti. Gjithashtu, Pirro Sh.p.k. nuk është përgjegjës për probleme që mund të lindin për shkak të mungesës së antivirusit, firewall-it apo browser-it të pa përditësuar në kompjuterin e vizitorit gjatë hyrjes në faqen e Pirro Sh.p.k. Klienti merr vetë përsipër të përdorë pajisjet dhe programet e duhura për t’u mbrojtur nga sulme të jashtme (viruse, site të ndryshme, etj.) për të kryer blerje elektronike. Pirro Sh.p.k. mund të vendosë në çdo kohë të pezullojë, ndryshojë apo përfundojë ofrimin e produkteve në rrugë elektronike për shkak të punimeve të mirëmbajtjes, për

të përditësuar ose përmirësuar faqen ose për çfarëdo arsye tjetër.

Shkelja e këtyre kushteve dhe shkelja e afateve i jep të drejtë Pirro Sh.p.k. të ndërpresë një blerje në mënyrë elektronike, si dhe t'iu heqë aksesin në këtë faqe për këto arsye apo çfarëdo tjetër.

ÇMIMET DHE KOHA E PRODHIMIT

Çmimi për secilin artikull varet nga pesha, karati i metalit, dimensionet dhe cilësia e gurit të çmuar. Çmimet e afishuara në faqe janë për materialet e përzgjedhura nga menaxhimi, por nëse kërkohen materiale të personalizuar sipas kërkesës tuaj atëherë ju lutem na shkruani për informacione më të detajuara.

Koha e prodhimit varet nga artikulli i zgjedhur, mund të variojë nga 1-5 javë nga momenti që bëhet pagesa. Pas pagesës porosia juaj do ndiqet nga stafi përgjegjës i cili do t'ju kontaktojë

Për brenda vendit dergesat kryhen me postën Albanian Courier, ndërsa jashtë Shqipërisë dërgohen me anë të Fedex. Kosto e transportit është e përfshirë në çmimin e produktit pa kosto shtesë. Nëse doni ndihmë nga një profesionist që t'ju asistojë gjatë gjithë procesit të porosisë dhe dërgimit, duke përfshirë çdo lloj personalizimi të porosisë tuaj si p.sh: mbishkrimi me lazer, ju lutem na shkruani. Të gjitha porositë përfshijnë paketimin dhe çertifikimin e duhur (nëse aplikohet) pa pagesë shtesë.

Pagesa për produktin duhet të kryhet e plotë, përpara se të fillojë prodhimi apo dërgesa përkatëse.

MËNYRAT E PAGESËS

Klienti mund të kryejë pagesën me:

1. Pagesë në paypal info@pirro.al ,
2. Pagesë në llogarinë bankare,
3. Kartë bankare debiti ose krediti të cdo lloji.

Pagesa për produktin duhet të kryhet e plotë, përpara se të fillojë prodhimi apo dërgesa përkatëse.

Në rast se Argjendari Pirro gjendet në pamundësi për të përmbushur një pjesë të porosisë së Klientit si rrjedhim i shkaqeve të pavarura nga Pirro Sh.p.k., pagesës së Klientit do t'i zbritet çmimi i produkteve të padërguara dhe kostot përkatëse të dërgimit pasi të njoftohet përkatësisht për këto ndryshime.

Vini Re:

- Gjatë kryerjes së pagesës, Klienti lidhet automatikisht me serverin e pagesave, pjesë e sistemit të kontrollit të qendrës së përpunimit të të dhënave të bankës. Të dhënat bankare të Klientit, të mbrojtura nëpërmjet enkriptimit, nuk kalojnë nëpërmjet sistemeve elektronike të Pirro Sh.p.k. dhe nuk ruhen në sistemet elektronike të Argjendari Pirro.

ANULLIMI, KTHIMI DHE NDËRRIMI I POROSISË

Nëse keni kryer pagesën dhe doni që ta anuloni urdhrin pa përfunduar prodhimin apo dërgesën drejt jush, atëhere ju lutem shkruani sa më parë në info@pirro.al.

Nëse artikulli është dërguar drejt jush dhe ka një gabim në prodhim, ose nuk i përgjigjet kërkesave tuaja, mund ta ktheni ose ta ndërroni brenda 30 ditësh pune. Artikujt duhet të jenë në gjendjen e tyre fillestare, pa defekte, riparime ose

personalizime të aplikuara. Ndërrimet mund të aplikohen brenda 30 ditëve për artikuj me vlerë të njëjtë ose më të lartë. Kthimi dhe ndërrimi mund të bëhen në një nga dyqanet tona në Tiranë, ose të kontaktoni një nga përfaqësuesit tanë për metoda alternative me postë. Kompensimi i plotë në raste kthimi mund të kërkojë deri në 30 ditë për t'u kredituar.

Produktet e personalizuara në detaje dizajni nuk mund të kthehen apo të ndërrohen.

GARANCIA

Ne ofrojmë shërbime shtesë të përjetshme për artikujt e blerë, si p.sh.: riparime, personalizime, ndryshim përmasash, dhe pastrim. Ne mbrojmë cilësinë e produkteve tona, nëse keni ndonjë problem, ju lutem na kontaktoni dhe do të provojmë t'ju asistojmë në mënyrën më të mirë të mundshme. Porositë tuaja janë unike dhe të trajtuara me shumë seriozitet nga ekipi ynë, që do t'ju njoftojë në lidhje me detajet e porosisë gjatë procesit. Ju jeni gjithnjë të mirëpritur në dyqanet tona, për t'u konsultuar me asistentët tanë profesionistë.

- Procedura e kryerjes së blerjes/porosisë në rrugë elektronike.

Për të kryer blerje në rrugë elektronike, Klienti duhet të jetë mbi moshën 18 vjeç dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Regjistrimi është hapi i parë që duhet të kryejë Klienti që dëshiron të kryejë një blerje në këtë faqe. Gjatë regjistrimit, Klienti duhet të japë emrin, mbiemrin, adresën e tij elektronike,

si dhe fjalëkalimin e tij. Klienti detyrohet të japë të dhëna të vërteta dhe të sakta, të detyrueshme për identifikimin e tij. Fjalëkalimi është personal dhe duhet të ruhet i fshehtë nga Klienti dhe të mos zbulohet tek persona të tjerë. Klienti do të ketë akses në të dhënat e tij personale në hapësirën e Klientit, ose në rast se do të kryejë një porosi, Klienti duhet të identifikohet paraprakisht nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit, duke patur parasysh se fjalëkalimi nuk shërben për kryerjen e pagesave.

Klienti kryen porosinë nëpërmjet procedurës së përshkruar në faqen e internetit dhe konfirmon përmbledhjen e detajuar të porosisë, e cila përmban të dhëna mbi produktin e porositur, dhe çmimin e tij.

Argjendari Pirro nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi nëse në llogarinë përkatëse të Klientit kryen blerje apo porosi një person tjetër i cili është vënë në posedim të emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit me apo pa dijeninë e Klientit përkatës.

Verifikimi i të dhënave të Klientit dhe dhënia prej tij e numrit të kartës bankare përbëjnë nënshkrim dhe pranim të shprehur të të gjitha transaksioneve të kryera nga ana e Klientit në faqen e internetit të Argjendari Pirro. Argjendari Pirro nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi nëse karta bankare, të dhënat e së cilës janë vendosur me qëllim kryerjen e pagesës është një kartë e vjedhur apo e deklaruar e humbur, në rast se banka përkatëse konfirmon pagesën.

Argjendari Pirro nuk mban përgjegjësi për mosfunksionimin e faqes së internetit, që mund të vonojë ose të mos lejojë kryerjen e porosive në rrugë elektronike, për shkak të ngjarjeve përtej kontrollit të arsyeshëm të Argjendari Pirro apo për shkak të punimeve të mirëmbajtjes të kryera në faqen e internetit.

